



**AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM
KOSOVO ACCREDITATION AGENCY
AGENCIJA ZA AKREDITOVANJE KOSOVA**

Student's Center, 2nd floor, 10000 Prishtina, Kosovo, tel. +381 38 213722, fax +381 38 213087
www.akreditimi-ks.org, email: kaaoffice@gmail.com

Nr. 255/15 Dt. 20.04.2015

Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXI-të të mbajtur më 01.07.2014, duke u bazuar në rekomandimin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (ndryshimin) e vendimit nr. 424/12, datë 09.07.2012 të KSHC-së i Universitetit "Ukshin Hoti"

1. Korrigjohet (ndryshohet) Vendimit i KSHC-së i datës 04.07.2014, nr. 543/14 i Universitetit "Ukshin Hoti"
2. Korrigjohet (ndryshohet) numri i kredive (ECTS) nga 180 në 240 kredi (ECTS) kredi për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze.
3. Ky vendim hynë në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m


4. Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë, rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, dhe kërkesës së Universitetit "Ukshin Hoti" te Prizrenit nr.18/15, datë 10.02.2015 për përmirësimin e vendimit të KSHC-së për programin e

studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze që nga 180 kredi (ECTS) të ndryshohet në 240 kredi (ECTS), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

5. **Këshilla juridike:** Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimi të KSHC-së brenda afatit të paraparë ligjor.

Vendimi u dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti",
- MASHT-it,
- Arkivit


Ferdije Zhushi Etemi, kryetare
Këshilli Shtetëror i Cilësisë

